

Vendim nr. 283, datë 07.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 07.11.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (M) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: MARK KULLA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-564, datë 27.03.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe një shtetas tjetër me inicialet P.K. kanë bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (*Prokuroria e Shkodrës*). Për këtë arsye, Prokuroria e Shkodrës ka regjistruar kallëzimin penal të datës 02.03.2018.

2. Sipas kallëzimit penal rezulton se kërkuesi dhe shtetasi P.K. janë palë në një proces civil pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt detyrimin e shtetasve D.SH.H., I.H., D.A., B.H. dhe B.H. të njohin pronarë me anë të parashkrimit fitues kërkuesin dhe shtetasin P.K. për sipërfaqen S 450 m², si dhe sipërfaqen 4.150 m². Sipas kallëzuesve gjatë gjyqimit të kësaj çështjeje civile janë paraqitur prova shkresore, për të cilat ata kanë dyshimin se janë të falsifikuara nga vetë paditësi dhe në dijeni të plotë të këtij fakti po përdoren në këtë gjykim për të manipuluar vendimmarrjen e gjykatës në lidhje me objektin e padisë.

3. Ndërkohë, Prokuroria e Shkodrës, me vendimin e datës 15.03.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se nuk janë konstatuar elemente të ndonjë vepre penale. Ndaj këtij vendimi kanë paraqitur ankim kallëzuesit, për të cilin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 70 (1946), datë 25.04.2018, ka vendosur rrëzimin e tij. Mbi ankimin e kallëzuesve, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është prishur nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 164, datë 04.06.2018. Sipas gjykatës së apelit, Prokuroria e Shkodrës duhet të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme në lidhje me këtë kallëzim, duke lënë edhe detyrat në pjesën arsyetuese të vendimit.

4. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, të përcaktuara në vendimin nr. 164, datë 04.06.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër, Prokuroria e Shkodrës ka kërkuar pushimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1174 (3299), datë 21.09.2020, ka vendosur mospranimin e kërkesës së Prokurorisë së Shkodrës për pushimin e procedimit penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP) dhe kthimin e akteve asaj prokurorie për kryerjen e hetimeve.

5. Pas rinisjes së hetimeve nga ana e Prokurorisë së Shkodrës janë kryer veprimet hetimore të kërkuara dhe është paraqitur përsëri kërkesa për pushimin e procedimit penal. Këtë qëndrim të Prokurorisë së Shkodrës e kanë kundërshtuar përsëri kallëzuesit, sipas të cilëve është e nevojshme të kthehet çështja për vazhdimin e hetimeve.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1740 (3717), datë 12.07.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Shkodrës dhe pushimin e procedimit penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së, pasi nuk provohej kryerja e saj. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim, ndër të tjerë, edhe kallëzuesit (kërkuesi dhe shtetasi P.K.).

7. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 260, datë 15.11.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1740 (3717), datë 12.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs, ndër të tjerë, edhe kallëzuesit.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-564, datë 27.03.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve, për shkak se nuk përmbajnë shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

9. Në datën 15.07.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

10.1. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh vendimin penal nr. 3367/290 të Regjistrimit Themeltar, datë 04.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në të cilin citohet se ka rezultuar i provuar se fakti penal për kryerjen e veprës penale ka ndodhur në vitin 2019.

10.2. *Neni 15 i Kushtetutës*, pasi është detyrë e organeve publike të respektojnë dhe të realizojnë përmbushjen e të drejtave themelore të njeriut, siç është e drejta për sigurinë juridike për të mos përdorur dokumente të falsifikuara, gjë që përbën cenim të së drejtës së pronësisë.

10.3. *Neni 41 i Kushtetutës*, pasi kushdo ka të drejtën të gëzojë e posedojë qetësisht pronën e tij dhe të mos cenohet nga dokumente të falsifikuara.

10.4. *Neni 42 i Kushtetutës*, pasi është cenuar e drejta për proces të drejtë ligjor, për shkak se Gjykata e Lartë duhet të pranonte rekursin, bazuar në gjetjet e vendimit penal nr. 3367/290 të Regjistrimit Themeltar, datë 04.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në të cilin citohet se ka rezultuar i provuar se fakti penal për kryerjen e veprës penale ka ndodhur në vitin 2019. Duke mos pranuar këtë vendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është treguar i njëanshëm.

10.5. *Parimi i një gjykimi të drejtë*, pasi kërkuesi ka paraqitur kërkesë për një fakt të ri sipas vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë që të prishte vendimet e pushimit të çështjes penale dhe të rikthente çështjen për hetime. Kjo kërkesë nuk është marrë parasysh nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit nuk ka marrë parasysh faktin e ri vendimtar, vendimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili prishte vendimin e pushimit të çështjes lidhur me veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuësin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e çështjes në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

13. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të ankimit kushtetues individual, vëren se ato kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh vendimin penal nr. 3367/290 të Regjistrisë Themeltar, datë 04.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në të cilin citohet se ka rezultuar i provuar se fakti penal për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së, ka ndodhur në vitin 2019.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se vlerësimi i provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si dhe të vlerësimit të provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nga sa më lart, referuar pretendimeve të kërkuarit, Kolegji konstaton se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e vlerësimit të provave, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kërkuari nuk ka sjellë asnjë argument konkret kushtetues për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Në kushtet kur kërkuari nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës sesi ka vepruar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në zgjidhjen e çështjes konkrete, këto pretendime të tij mbeten me natyrë të pastër ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

16. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.